



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilimje/Prodato Received/Delivered	16.05.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	4265/2023		114



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr. 532/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e dhe vendoset e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar-Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. nr. 532/2023, të datës 17.03.2023, së ankuesit

kundër organit të punësimit Agjencia e Kosovës për Akreditim në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar A. nr. 532/2023, të datës 17.03.2023, së ankuesit

II. SHFUQIZOHET, Vendimi me numër protokollit 158/2023, i datës 15.02.2023, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

III. Vendimi hynë në fuqi në ditën e ndëshkimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 17.03.2023 e cila është regjistruar me numër protokollit 2771/2023 me pretendimet ankimore kundër vendimit me numër protokollit 30/23 të datës

13.01.2023, si dhe njoftimit të datës 13.01.2023, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 31.03.2023, me numër protokolli 3238/2023 ka bërë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Agjencia e Kosovës për Akreditim ndërsa më datë 14.04.2023, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka dërguar përgjigje në ankesë tek Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 532/2023 e datës 17.03.2023, e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 2771/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 13.01.2023, i Njesisë së Burimeve Njerëzore; Njoftimi me numër protokolli 44/23 i datës 13.01.2023, i Njesisë së Burimeve Njerëzore; Ankesa e datës 10.02.2023, drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore; Vendimi i datës 15.02.2023, i Njesisë se Burimeve Njerëzore; Vendimi i datës 13.02.2023, i Njesisë se Burimeve Njerëzore; Njoftimi i datës 13.01.2023, i Njesisë se Burimeve Njerëzore; Vendimi me numër protokolli 34/23, i datës 13.01.2023; i Njesisë se Burimeve Njerëzore; Vendimi me numër protokolli 36/23, i datës 13.01.2023; i Njesisë se Burimeve Njerëzore; Vendimi me numër protokolli 41/23, i datës 13.01.2023; i Njesisë se Burimeve Njerëzore; Vendimi me numër protokolli 33/23, i datës 13.01.2023; i Njesisë se Burimeve Njerëzore; Vendimi me numër protokolli 154/2022, i datës 16.11.2022; Vendimi i datës 06.09.2022, për Themelimin e Komisionit përzgjedhës; e-maili i datës 09.09.2022; Vendimi me numër protokolli 1163/2022, i datës 05.09.2022; Vlerësimi i rezultateve nëpërmjet intervistës me gojë; Formuari individual i vlerësimit; Renditja përfundimtare e kandidateve; Aplikacionin i Faton Pllana, me shkresat e bashkangjitura; Aplikacionin i Linda Krasniqi - Osmani, me shkresat e bashkangjitura; Aplikacionin i Janina Shala, me shkresat e bashkangjitura; ; Aplikacionin i Bekim Brahimi, me shkresat e bashkangjitura; Konkursi i datës 27.07.2022; Njoftimi i datës 05.10.2022; Akt Emërimi i datës 01.10.2012; Diplomë me numër 4521 e datës 04.04.2026; Diplomë me numër 103 e datës 27.12.2012; Vërtetim i datës 10.08.2022; Certifikatë e datës 10.10.2015; Certifikatë e muajit mars të vitit 2018; Vërtetim i datës 12.01.2010; Vërtetimin i datës 10.08.2022; Formuluar për vlerësim e rezultateve në punë; Akt Emërimi i datës 01.03.2017; Diplomë e datës 19.09.2013; Diplomë e datës 10.10.2019; Formuluar për vlerësim e rezultateve në punë; Vërtetimi i datës 26.02.2021; Diplomë e datës 12.12.2012; Diplomë e datës 30.11.2006; Vërtetim i datës 23.06.2022; Kontrata e Punës e datës 02.09.2017; Akt Emërimi i datës 28.07.2022; Vërtetimi i datës 11.12.2018; Akt Emërimi i datës 11.10.2019; Diplomë e datës 27.08.2017; Diplomë e datës 10.02.2019; Vërtetim i datës 28.02.2022; Vërtetim i datës 10.09.2016; Certifikatë e datës 11-12-22, e muajit mars të vitit 2019; Certifikatë e datës 01-02 e muajit nëntor të vitit 2018; Formuluar për vlerësim e rezultateve në punë; Akt Emërimin e datës 01.03.2022; Diplomë e datës 01.09.2015; Diplomë e datës 17.08.2020; Certifikatë e datës 12 dhe 13 e muajit korrik të vitit 2022; Akt Emërimi i datës 01.07.2018; Diplomë e datës 05.03.2016; Diplomë e datës 13.03.2022; Vërtetim i datës 31.03.2022; Vërtetim i datës 30.03.2022; Vendimi i datës 19.03.2021; Akt Emërimi i datës 07.07.2018; Vërtetim i datës 30.03.2022; Diplomë e datës 11.10.2016; Diplomë e datës 21.05.2021; Vendim i datës 19.03.2019; Verimi i datës 22.03.2022; Vërtetim i datës 30.06.2017; Diplomë e datës 30.09.2011; Kontrata e punës e datës 06.06.2012; Përgjigje në ankesë, me numër protokolli 6551/2023, e datës 13.04.2023, e-maili i datës 16.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës del se Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me qëllim të zbatimit të Vendimit A. Nr. 532/2023, të Këshillit Njësia e Burimeve Njerëzore me numër protokollit 30/23 të datës 13.01.2023, ka nxjerr vendim me të cilin me të cilin ka konstatuar se ankuesi Agim Blakçori nuk i plotëson kushtet për të vazhduar për konkursi e mëtejme për lëvizje paralele brenda kategorisë për pozitën „Zyrtar për Monitorim dhe Vlerësim“, po të njëjtën datë Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencia e Kosovës për Akreditimit për mes njoftimit me numër protokollit 44/23, të datës 13.01.2023, ka njoftuar se asnjëri nga kandidatet nuk i plotëson kushtet që kanë aplikuar në konkursin për pozitën „ Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Vlerësim“.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër protokollit 30/23, të datës 13.01.2023, si dhe njoftimin me numër protokollit 44/23, të datës 13.01.2023 me datë 10.02.2023, me ankesë i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Akreditim, andaj mbi bazën e kësaj kolegji konstaton se ankuesi ankesën në brendshme, e ka parashtruar jashtë afatit ligjore për parashtrimin e ankesave, dhe mbi bazën e kësaj kolegji konstaton se ankesa e ankuesit është jashtë afatit për parashtrimin e ankesave.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar ankesën e ankuesit që e ka parashtruar në Njësinë e Burimeve Njerëzore tek Agjencia Kosovës e Akreditimit ankuesi ankesën pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore e ka parashtruar në kundërshtim me nenin 45, paragrafi 6 nën paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: “ 6.Brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë NJBNJ. Ankesa shqyrtohet nga NJBNJ dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj.1.Kundër rezultatit të fazës të vlerësimit, çdo kandidat i interesuar, mund të paraqesë ankesë të brendshme, brenda shtatë (7)ditëve nga data e njoftimit individual.2.Ankesa shqyrtohet nga KVLBK, dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj”.

Kolegji, konstaton se veprimet juridike sa i përket këshillës juridikë, në vendimin me numër protokollit 30/23, të datës 13.01.2023, si dhe njoftimin me numër protokollit 44/23, të datës 13.01.2023, me datë 10.02.2023, ka qenë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, dukë i dhënë këshillën juridike, në afatin ligjor në afatin prej shtatë (7) ditësh, ndërsa ankuesi edhe përkundër faktit se ka qenë e dhëne këshilla juridikë, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi nga Njësia e Burime Njerëzore e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, ankuesi ankesën e ka parashtruar tek Njësia e Burime Njerëzore, jashtë afatit ligjor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, ka nxjerr vendim me numër protokollit 158/2023, të datës 15.02.2023, me të cilin vendim ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj, duke vepruar në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1, nën paragrafi

1.1,1.2,1.3,1.4,1.5,1.6dhe 1.7, të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se; 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji;1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë;1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;1.5. është në kundërshtim me ligjin material;1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit, sepse në rastin konkret Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Kosovës për Akreditim nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike sa i përket pranimit të afatshmerise së ankesës së ankuesit të parashtruar me datë 10.02.2023.

Ndërlidhur me këtë çështje juridike, administrative, kolegji i këshillit nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimor të ankuesit për pozitën „ Zyrtar për Monitorim dhe Vlerësim“, sepse ankuesi ankesën e ka parashtruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore në fuqi.

Theksuar si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr. 532/2023

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Eshref SHABANI


Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë e Kosovës për Akreditim;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim;
- Arkivit të KPMSHCK-së,